



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1093/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e Njomza Grabanica nga rradhët e subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kandidat për asamblë kuvendit komunale në Klinë, paraqitur kundër komisionereve të vendotimeve, për shkak të parregullsive në manipulim e votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Njomza Grabanica kandidate për kuvendin komunal në Klinë nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Njomza Grabanica nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila thekson se në vendvotimin në Klinë dhoma nr.5 , në Budisalc dhoma nr. 3 , në Jashanic dhoma nr. 3, në Sferk dhoma nr. 2 dhe nr.3, ajo dyshon se i janë ndryshuar votat dhe ia janë dërguar dikujt tjetër mbrenda subjektit AAK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Njomza Grabanica nga komuna e Klinës PZAP-i, vlerëson ankesa në fjalë është si të pa bazuar dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse dhe mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1093/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.